

VENDIM
Nr.584, datë 10.9.2004

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.70, DATË 15.2.2001 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR STATUSIN E SPITALEVE UNIVERSITARE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 3 e 4 të ligjit nr.3766, datë 17.12.1963 “Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të nenit 5 të ligjit nr.8461, datë 25.2.1999 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të neneve 124 e 128 të ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.70, datë 15.2.2001 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen këto ndryshime:

a) Paragrafi i parë i pikës 1 ndryshohet si më poshtë vijon:

“Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, Tiranë, Spitali Universitar i Sëmundjeve të Mushkërive “Shefqet Ndroqi”, Tiranë, Spitalet Universitare Obstetrike-Gjinekologjike nr.1 e nr.2 Tiranë dhe shërbimi kirurgjikal i spitalit rajonal të Durrësit janë qendra kombëtare mjekimi, arsimimi dhe kërkimi, në bashkëpunim me Fakultetin e Mjekësisë të Universitetit të Tiranës.

Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, Tiranë, Spitali Universitar i Sëmundjeve të Mushkërive “Shefqet Ndroqi”, Tiranë, Spitalet Universitare Obstetrike-Gjinekologjike nr.1 e nr.2, Tiranë, kryejnë edhe shërbimin spitalor sekondar për Tiranën, ndërsa shërbimi kirurgjikal i spitalit rajonal të Durrësit kryen edhe shërbimin spitalor sekondar për Durrësin.”.

b) Paragrafi i dytë i pikës 4 ndryshohet si më poshtë vijon:

“Drejtorët e Spitalit Universitar të Sëmundjeve të Mushkërive “Shefqet Ndroqi”, Tiranë, të Spitaleve Universitare Obstetrike-Gjinekologjike nr.1 e nr.2, Tiranë, si dhe shefi i shërbimit kirurgjikal të spitalit rajonal të Durrësit emërohen nga Ministri i Shëndetësisë.”.

2. Ngarkohen Ministri i Shëndetësisë, Ministri i Arsimit dhe i Shkencës dhe Ministri i Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano